# EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së katërt të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 24.9.2026, me fillim në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Lindita Rexhepi Osmani, Feim Osmani, Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok, Faton Marolli, Teuta Kadiu Gjinolli, Adnan Ajeti.

**Mungoi:** Oktay Kurtesh.

**Në mbledhje morën pjesë edhe**: Slavica Stolic, zyrtare për komunitete në ZKKK Fatlinda Bajrami, udhëheqëse e planifikimit në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave (DIKMK).

Në mungesë të kryesuesit të Komitetit mbledhjen e hapi dhe e kryesoi zv. kryesuesi i Komitetit, Faton Marolli, me këtë

## REND DITE:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
2. **Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Zyhrije Pllana;**
3. **Formimi i Komisionit për vizita në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë;**
4. **Raporti i punës së ZKKK-së për muajin korrik 2026 (si dhe informatë lidhur me planifikimin e projekteve të ZKKK-së për vitin 2026, për komunitetet jo shumicë);**
5. **Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumice lidhur me gjendjen në bashkësinë e tyre;**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

6. **Të ndryshme.**

**Pika e parë**
**Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**
Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

**Pika e dytë**
**Ftesë për drejtoren e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave, Zyhrije Pllana.**

**Nenad Miladinovic –** sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se qysh para katër viteve kemi pasur kërkesa lidhur me disa projekte të cilat kanë qenë aktuale, mirëpo deri më tani nuk është bërë asgjë.
Ai në vazhdim tha se një prej projekteve që është realizuar është kanalizimi dhe rrjeti i ujësjellësit, ku pas këtyre punimeve është dashur të bëhet mbulimi i gropave dhe asfaltimi i rrugës, por kjo ende nuk është realizuar, gjë që paraqet problem për qarkullimin e autobusëve, kamionëve dhe automjeteve pasi që nuk mund të tejkalojnë njëri-tjetrin.
Ai tha se ky problem është prioritet, andaj ju kisha lutur që të gjeni kohë dhe të vini në vend të ngjarjes dhe të bindeni me gjendjen faktike të rrugës. Nëse është e mundur, ju kisha lutur që ai projekt të realizohet në kohën sa më të shkurtër.

**Fatlinda Bajrami - udhëheqëse e planifikimit në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave (DIKMK.**
Sa i përket shqetësimit të z. Miladinovic, tha se është e vërtetë që gjatë viteve të kaluara është punuar dhe ka pasur kontratë aktive në Bërnicë dhe Bardhosh. Është e vërtetë që në rrugën e cekur nuk është bërë asfaltimi i rrugës dhe mbulimi i gropave, e kemi trajtuar, por nuk është realizuar ende.
Tani po flas për vitin 2026 lidhur me gjendjen faktike dhe reale, se nuk kemi mundësi me e asfaltuar atë rrugë për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, ku jemi duke pritur të miratohet buxheti për vitin 2027 në javën e ardhshme. E kemi paraparë edhe investimin në Bardhosh dhe Bërnicë.
Ajo u shpreh se, meqë unë si udhëheqëse çdo javë kam takim me banorët nga Bardhoshi dhe Bërnica, ku që tani ju premtoj juve personalisht dhe të gjithë banorëve në atë zonë, së bashku me drejtoreshën, por edhe në mungesë të drejtoreshës do ta marr si prioritet kërkesën tuaj, jo më larg se në javën e ardhshme, me dalë së bashku me ekipin dhe me e shikuar gjendjen faktike në rrugën e cekur që është për momentin, për ta marrë një raport që në vitin 2027 apo sa të miratohet buxheti të implementohen kontratat, të ndërhyjmë bile me e sanuar gjendjen e ta bëjmë të jetueshme për banorët.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

**Nenad Miladinovic** – duke u ndërlidhur në diskutim, tha se do të ishte mirë që të dilni në terren sa më shpejt që është e mundur, pasi që duke pasur parasysh se po vjen dimri dhe sigurisht është e nevojshme që të bëhet ndonjë intervenim në ndonjë pjesë që komunikacioni të zhvillohet normal, sidomos tek ato pjesët të cilat janë të rrezikshme, si p.sh. aty ku ka gropa të mëdha sikurse edhe tek një pjesë e rrugës përskaj lumit ku asfalti është rrënuar.

**Fatlinda Bajrami** – lidhur me diskutimin e z. Miladinovic, tha se nëse më lejohet, më duhet një numër kontaktues nga ju.
Ajo premtoi se urgjentisht do t'i përcjellë kërkesat e Komitetit, dhe që më së largu në javën e ardhshme të dilet në terren për konstatimin e gjendjes.

**Feim Osmani** – shtroi pyetje se a ka ndonjë informatë lidhur me kërkesën e bërë nga kryetari i Bashkësisë Lokale në fshatin Besi lidhur me një trotuar në rrugën kryesore të fshatit, e cila sipas informatave që kam, kërkesa ka pasur edhe nënshkrimet e komunitetit ashkali, për arsye se shtëpitë e tyre janë në fund të fshatit dhe i kanë fëmijët në shkollë, kurse rruga është dëmtuar jashtëzakonisht shumë në të dy anët e rrugës.
Prandaj, më intereson se a janë marrë parasysh kërkesat e banorëve dhe të Bashkësive Lokale, që në atë rrugë rreth 1.2 kilometër të bëhet një trotuar, pasi që janë bërë tri vite nga kërkesat e banorëve, e posaçërisht nga komuniteti ashkali për arsye se ata e kanë shkollën më së largu.

**Fatlinda Bajrami** - lidhur me diskutimin e z. Osmani, tha se unë si udhëheqëse e planifikimit i marr kërkesat nga të gjitha Bashkësitë Lokale. Dje kam marrë kërkesë nga Bashkësia Lokale dhe e kam parë një kërkesë të tillë. Jemi jemi duke e planifikuar buxhetin për vitin 2027, ku nuk kemi specifikuar dhe nuk kemi ndarë ende asnjë rrugë përveç vijave buxhetore se ku do të investohet.
Ajo në vazhdim tha se kemi ndarë buxhet prej 2 milion euro, që do të investohet nëpër fshatra të ndryshme të Prishtinës, ku me siguri do të përfshihet edhe fshati Besi.

**Feim Osmani** – duke u ndërlidhur në diskutimin, tha se sa i përket premtimeve ato duhet të na i jap drejtoresha, kurse ju jeni ftuar që të na informoni se a ka shkuar për detyrë projektuese, a është trajtuar kërkesa, apo a kanë dalë inxhinierët në terren për verifikim në vend të ngjarjes, pasi që kërkesa nuk është e vitit 2026 por është kërkesë e viteve të mëhershme.

**Fatlinda Bajrami** - lidhur me diskutimin e z. Osmani, tha se unë po flas për kohën prej se është drejtoresha në detyrë, qe gjashtë muaj e këndej nuk kemi gjetur projekt për trotuare, si dhe nuk ka pasur nismë që ka me u kryer trotuari në atë



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

pjesë, e nuk e di se pse. Për vitin 2027 do ia përcjellë drejtoreshës që patjetër me e shikuar mundësinë me e kryer.

**Mirsada Behluli** - shtroi pyetje se a është në kompetencën tuaj rregullimi i shkallëve tek trotuaret, pasi që në lagjen "Kalabria", rr. "Sylejman Vuçitrna" shkallët tek kontejnerët të cilat shërbejnë për të kaluar prej një ane në anën tjetër të rrugës, janë në gjendje katastrofale, të cilat nuk munden me u përdorur.
Andaj do të ishte mirë që të dilni dhe ta verifikoni gjendjen, meqë është investim i vogël dhe do të ishte lehtësim i madh për banorët të cilët jetojnë në atë zonë.

**Fatlinda Bajrami –** duke iu përgjigjur znj. Behluli, tha se edhe pse po e marr si kërkesë, ne jemi duke punuar me një kontratë të NPB-së, ku jemi duke bërë sanime të ndryshme ku është e nevojshme edhe në zona emergjente.
Mirëpo unë po e marr si kërkesë që ta dërgoj tek menaxheri i kontratës dhe nëse nuk ka nevojë për investim të madh, por vetëm për sanim të vogël me e kryer pa projekt.

**Slavica Stolic,** duke u ndërlidhur në diskutimin e z. Miladinovic lidhur me këto projekte, tha se këto projekte janë tash e një kohë të gjatë, pra më shumë se pesë vite që paraqesin problem.
Mirëpo unë do ta ceki problemin për fshatin Slivovë, që ka të bëjë me ujin e pijshëm, meqë kemi pasur premtime edhe nga vet kryetari i Komunës, se ai problem do të zgjidhet, por ai po sillet prej vitit në vit e asgjë nuk po ndërmerret.
Pra, ju kisha lutur që në projekt ta cekni edhe rastin e fshatit Slivovë, lagjja e epërme.

**Faton Marolli** tha se meqë kam pasur takim me drejtoreshën, më 28 korrik, ku dhe kam shprehur shqetësimin lidhur me rrugën "Bedri Gjini", ku një pjesë e rrugës është asfalt, i cili është dëmtuar disa herë nga vetë qytetarët, kurse pjesa tjetër është me kubza.
Kam kërkuar nga drejtoresha që të sanohen ato gropa dhe më është premtuar se sapo të përfundohet me rrugën "Ilir Konushevci" do të trajtohet rruga "Bedri Gjini", mirëpo ajo ende nuk është realizuar.
Prandaj më intereson se çka po ndodh me realizimin e kërkesës.

**Fatlinda Bajrami** – sa i përket punës së drejtoreshës tha se është e vërtetë se ka vullnet të madh për të punuar, por jemi duke punuar me një kontratë të NPB-s, ku jemi duke i shfrytëzuar për me i sanuar rrugët.
Ajo mes tjerash tha se aktualisht jemi duke punuar në rrugën "Hollgen Petersen", ku e kemi parë se është një gjendje shumë e keqe dhe kemi pasur kërkesa të shumta për sanimin e asaj rruge.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

**Nenad Miladinovic** tha se nuk e di se a është në dijeni zonja apo zonjusha, se ZKKK i ka mjet në buxhet 120 mijë euro në nivel vjetor, të cilat janë të dedikuara për investime kapitale për komunitetet jo shumicë.

**Pika e tretë**
**Formimi i Komisionit për vizita në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë.**

Pas shumë diskutimesh dhe propozimesh, u formua komisioni për vizita në shkolla ku vijojnë mësimin nxënësit e komuniteteve jo shumicë.
Komisioni është në këtë përbërje: Oktay Kurtesh nga komuniteti turk, Mirsada Behluli, nga komuniteti boshnjak, Nenad Miladinovic, nga komuniteti serb, Faton Marolli, nga komuniteti ashkali, Kimeta Shok, nga komuniteti goran, Adnan Ajeti, nga komuniteti rom, Lindita Rexhepi, Feim Osmani, Teuta Kadiu, nga asambleja komunale dhe Slavica Stolic, Valentina Mehmeti nga ZKKK.

**Pika e katërt**
**Raporti i punës së ZKKK-s për muajin korrik 2026 (si dhe informatë lidhur me planifikimin e projekteve të ZKKK-së për vitin 2026, për komunitetet jo shumicë)**

**Slavica Stolic-** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se raportin të cilin e keni marr, është pjesa e aktiviteteve të mia, pasi që, duke marrë parasysh se jam vetëm një zyrtare në ZKKK.
Ajo në vazhdim tha se gjatë aktiviteteve kam pasur takim me znj. Igballe nga IOM-i, ku më është thënë se data 30 shtatori është afati i fundit për aplikim që ka të bëjë me biznes, projekte për komunitetet jo shumicë, ku të gjithë ata të cilët janë të interesuar janë të mirëseardhur për të aplikuar.
Përveç takimit me IOM ka pasur takim edhe me organizatat tjera të ndryshme, me UNMIK, me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, ku është diskutuar lidhur me problemet me të cilat ballafaqohen komunitetet jo shumicë.
Po ashtu, kemi pasur takim edhe tek kryeministri, Albin Kurti, ku kanë qenë të ftuara të gjitha Zyrat për Komunitete të komunave të Kosovës, ku kemi pasur mundësinë t'i paraqesim problemet me të cilat ballafaqohen zyrat për komunitete në Kosovë.
Po ashtu, është cekur që në sportelet për shërbim me qytetarë në të ardhmen të punësohen të gjithë përfaqësuesit të cilët e dinë gjuhën shqipe dhe serbe, për shkak të shërbimeve sa më efikase për qytetarët.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

**Mirsada Behluli** shtroi pyetje lidhur me ndërtimin e atyre 100 shtëpive se cilat regjione i mbulojnë, a hynë aty edhe Prishtina.

**Slavica Stolic** - lidhur me pyetjen e shtruar nga znj. Behluli tha se ajo çështje i përket Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

**Feim Osmani** - shtroi pyetje se kur bëhet kërkesa për ndërtimin e shtëpisë a kërkohet me u trajtuar si rast social, apo kërkesa për ndërtim të shtëpisë për shkak të dëmtimit të shtëpisë si pasojë e luftës.

**Slavica Stolic** – lidhur me pyetjen e shtruar nga z. Osmani, tha se kemi dy raste të ndryshme, pra kemi kërkesën për personat e shpërngulur dhe atë për raste sociale, mirëpo adresimi më tepër shkon për personat të cilët i kanë shtëpitë e dëmtuara dhe janë raste sociale.
Kur është fjala për të riatdhesuarit, duhet të jetë mbështetja nga kryeministri dhe Ministria për Kthim dhe Komunitete.

**Feim Osmani** kërkoi sqarim lidhur me kërkesat e personave të riatdhesuar, duke pasur parasysh se të gjithë banorët e Kosovës kanë pasur pronën e vet, a nuk është intervenuar tek riparimi i shtëpisë apo nuk kanë pasur fare e duan të trajtohen si raste sociale.

**Kimeta Shok-** lidhur me pyetjen e z. Osmani, tha se arsyeja është se kur kemi shkuar herën e fundit për vizitë në Ministri, na është thënë se Prishtina nuk përfshihet në program.

**Nenad Miladinovic** – duke u ndërlidhur në diskutim, tha se sa i përket ndihmës financiare nga Ministria për Kthim dhe Komunitete, janë tri lloje të ndihmave financiare. Kategoria e parë ka të bëjë me kthimin e të riatdhesuarve, kategoria e dytë ka të bëjë me strehimin e të riatdhesuarve dhe kategoria tretë është rastet sociale.
Këto grupe dhe nëngrupe kanë punuar me kapacitet të plotë, mirëpo, për fat të keq, tani ministri vendos se kujt do t'i ndërtohet shtëpia.

**Kimeta Shok** – shtroi çështjen e një familjeje të komunitetit goran, e cila ka një muaj që është kthyer nga Franca, e nuk kanë ende as dokumente të rregulluara, kanë nevojë për riparim të shtëpisë, pasi që 6-7 vjet nuk kanë qenë aty.
Njëri prej anëtarëve të asaj familjeje ka qenë në ZKKK dhe i është thënë se do t'i përgjigjen, mirëpo ende nuk ka asnjë përgjigje.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

**Slavica Stolic –** lidhur me diskutimin e znj. Shok, tha se pala nga komuniteti goran nuk ka qenë tek unë në zyrë.
Duke u ndërlidhur me z. Miladinovic, tha se fjala është për të shpërngulurit intern brenda Kosovës, të shpërngulurit jashtë Kosovës gjatë viteve të 90-a, si dhe rastet sociale.
Pas shumë diskutimesh dhe sugjerimesh, u vendos që t'i bëhet ftesë kryetarit për me e plotësuar ZKKK-në qysh kishin me funksionuar punët më mirë në shërbime për ne si Komitet dhe për banorët.

**Pika e pestë**
**Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve jo shumice lidhur me gjendjen në bashkësinë e tyre.**

**Nenad Miladinovic –** lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, tha se do ta ripërsëërisë prapë çështjen e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, pasi që ka të bëjë me deponitë ilegale, ndriçimin e rrugëve, ku në pjesën e lagjes 80% e dritave janë djegur.
Ai në vazhdim ceku edhe çështjen e Kompanisë "Pastrimi", e cila ka për detyrë çdo të shtunë, do të thotë njëherë në javë të mbledh mbeturinat, ndërsa tani vijnë dy herë në muaj, andaj apelojë tek organet kompetente të Komunës që të intervenojnë tek kjo kompani, që ta kryen punën e saj siç duhet, pasi që të gjithë jemi parapagues të rregullt të mbeturinave.

**Kimeta Shok –** tha se po ashtu ka kërkesë për Drejtorinë e Shërbimeve Publike, që në rrugën tek Xhamia e Llapit e deri tek rruga e Lezhës nuk funksionojnë poçat elektrik.

**Faton Marolli** - tha se shpresoj që në mbledhjen e ardhshme do ta ftojmë drejtorin apo ndonjë zyrtar kompetent të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, dhe t'i shtrojmë problemet të cilat i kemi që i përkasin kësaj drejtorie.
Mirëpo sa unë e di, Drejtoria e Shërbimeve Publike ka pasur një kontratë për rregullimin e dritave, e a e ka ende nuk e di, por dot të informohemi në takimin e ardhshëm.
Sa u përket mbeturinave, në të njëjtën situatë jemi edhe ne të gjithë.

**Pika e gjashtë**
**Të ndryshme**

**Mirsada Behluli –** tha se do të ishte mirë, pasi që po vjen dimri, deri në takimin e ardhshëm t'i përgatisim listat e familjeve të cenuara dhe rasteve sociale për ndihma materiale.



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org

Prandaj kisha propozuar që në takimin e ardhshëm të ftohet drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe t'i paraqesim problemet të cilat na shqetësojnë.

**Kimeta Shok** – shtroi pyetje se si qëndron situata me ato pakot që na janë premtuar qysh para dy muajve.

**Faton Marolli** - lidhur me listat që janë kërkuar për dorëzim, i kemi dorëzuar tek Valentina, mirëpo unë dua të ceku diçka tjetër lidhur me pakot. Ashtu siç e kam cekur edhe në mbledhjet e kaluara, se ka pasur një kontratë lidhur me pakot higjienike, por nuk e di se a ka skaduar ajo kontratë, pasi që Klaudia është marrë me atë punë.
Pra, ka qenë kontrata për pakot higjienike, e cila ka pasur të realizohet edhe këtë vit, por më duket se donë me skaduar kontrata pa u realizuar.

**Feim Osmani** – sa i përket kompanisë "Pastrimi", tha se në çdo mbledhje të Kuvendit unë debatoj me drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike ose me kryetarin, që do të thotë se me këtë problem nuk janë të prekur vetëm komunitetet por jemi të prekur të gjithë.
Ndërsa tani më intereson se ku mundemi me i dorëzuar listat me emra të familjeve të cenuara apo që janë raste sociale për ndihmat, si ato me dru zjarri etj., dhe çka duhet të dorëzohet prej të dhënave. Si dhe a mundemi me i dorëzuar listat edhe me e-mail apo duhet fizikisht.

**Faton Marolli** – duke u ndërlidhur në diskutim, tha se listat me emrat e familjeve të cenuara dorëzohen në ZKKK, kurse prej të dhënave duhet të dorëzohet kopja e letërnjoftimit, konfirmimi i bankës, nr. i llogarisë së bankës dhe numri i telefonit.
Prandaj propozoj që për takimin e ardhshëm të ftohen **drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Leutrim Retkoceri; drejtori i Drejtorisë së Arsimit, Arianit Elshani, dhe drejtori i Drejtorisë së Pronës, Brahim Mehmetaj.**

**Procesmbajtësja**
**Lendita Spahija**

**Kryesuesi i Komitetit**
**Oktay Kurtesh**



Adresa: Rr. UÇK- 2-10.000 Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 381(0)38/230-900
http://www.prishtina-komuna.org